

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Takimi i 61-të të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizivë, mbrojtja e fëmijëve online dhe edukimi mediatik, çështje prioritare për AMA-n

Në takimin e 61-të të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizivë (EPRA)...



Fq. 2

AMA Memorandum Bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës, Krasniqi: Angazhim i përbashkët për zbatimin e ligjit mbi kushtet e punës dhe mbrojtjen e gazetarëve



Fq. 2

Rregullimi i shërbimeve mediatike në epokën digjitale, Krasniqi takim pune me kryetaren e Autoritetit të Lartë për Komunikimin Audioviziv të Mbretërisë së Marokut

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, ka zhvilluar një takim...

Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, kryetarja e AMA-s merr pjesë në forumin e organizuar në Prishtinë

Forumi i organizuar nga Universiteti UBT në Prishtinë, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, mbledhi ...



Fq. 2



Fq. 3

Media shqiptare përballë fenomenit të Dezinformimit, tryezë e përbashkët mes AMA-s dhe Qendrës “Faktoje”

Media shqiptare përballë fenomenit të Dezinformimit ka qenë tema e tryezës së organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Qendra “Faktoje”...

AMA Memorandum Bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës, Krasniqi: Angazhim i përbashkët për zbatimin e ligjit mbi kushtet e punës dhe mbrojtjen e gazetarëve

Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Kjo marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, për marrjen e masave, me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin në sektorin e mediave audiovizive, në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimet dhe mirëqenien në punë. [Lexo më shumë](#)



Takimi i 61-të të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizivë, mbrojtja e fëmijëve online dhe edukimi mediatik, çështje prioritare për AMA-n

Në takimin e 61-të të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizivë (EPRA) i zhvilluar në Kishinau të Moldavi mori pjesë dhe Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi. Agjenda përfshiu disa pika mes të cilave, diskutimin mbi Forumin Global të Rrjeteve të UNESCO-s, me theks te edukimi mediatik, si dhe një sesion tematik mbi mbrojtjen e fëmijëve në platformat e shpërndarjes së videove dhe rrjetet sociale. [Lexo më shumë](#)



Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, kryetarja e AMA-s merr pjesë në forumin e organizuar në Prishtinë



Rregullimi i shërbimeve mediatike në epokën digjitale, Krasniqi takim pune me kryetaren e Autoritetit të Lartë për Komunikimin Audioviziv të Mbretërisë së Marokut

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, ka zhvilluar një takim pune me Latifa Akharbach, kryetare e Autoritetit të Lartë për Komunikimin Audioviziv (HACA) të Mbretërisë së Marokut. Gjatë kësaj tryeze, janë diskutuar çështje me interes të përbashkët, duke nisur nga rregullimi i shërbimeve mediatike në epokën digjitale, garantimi i pluralizmit mediatik, mbrojtja e të drejtave të përdoruesve të mediave etj.

[Lexo më shumë](#)

Forumi i organizuar nga Universiteti UBT në Prishtinë, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, mbledhi bashkë kryetaren e AMA-s, Znj. Krasniqi, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Besnik Berisha nga Komisioni i Pavarur i Medias së Kosovës, si dhe profesorë e gazetarë. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, u shpreh se etika në media është një detyrim por dhe sfidë në kohët e zhvillimit të teknologjisë dhe transformimit të medias.

[Lexo më shumë](#)



Media shqiptare përballë fenomenit të Dezinformimit, tryezë e përbashkët mes AMA-s dhe Qendrës “Faktoje”

Media shqiptare përballë fenomenit të Dezinformimit ka qenë tema e tryezës së organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Qendra “Faktoje”. Sipas gjetjeve të prezantuara nga Qendra “Faktoje”, 60% e gazetarëve të pyetur nuk e dinë përkufizimin e saktë të Dezinformimit, ndërkohë që 100% gazetarëve që punojnë në median online kanë pranuar se publikojnë informacione pa i verifikuar më parë për shkak të presionit të kohës.

[Lexo më shumë](#)